

“RALD Tech” Sh.p.k.

STATUTI

Kruje, më 03/12/2020

STATUTI

I
SHOQERISE “RALD Tech”Sh.p.k.

KAPITULLI I
Emërtimi, Forma Ligjore, Selia, Kohëzgjatja

Neni 1. Emërtimi i Shoqërisë

- 1.1. Emërtimi i Shoqërisë (“**Shoqëria**”) është “**RALD Tech**” sh.p.k. Në të gjitha dokumentet, faturat, reklamat dhe publikimet e nxjerra nga Shoqëria, emri i saj do të pasohet nga:
- a. Fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ;
 - b. Selia.

Neni 2. Forma Ligjore e Shoqërisë

- 2.1. Shoqëria Tregtare “**RALD Tech**” shpk është person juridik shqiptar, i organizuar ligjërisht si një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, në përputhje me ligjet e Shqipërisë dhe dispozitat e statutit aktual apo atyre që do vijojnë.

Neni 3. Selia e Shoqërisë

- 3.1. Selia e Shoqërisë është:Kruje,lagja nr 1,pallat i vjeter kati pare,zona kadastrale 8621 me nr pasurie 1

Shqipëri.Shoqëria rezervon të drejtën të transferojë selinë e saj në një adresë dhe/ apo në një qytet tjetër të Shqipërisë.

- 3.2 Shoqëria rezervon të drejtën të hapë filiale, degë dhe përfaqësi në qytete të tjera të Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4. Kohëzgjatja e Shoqërisë

- 4.1. Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pa përcaktuar.

KAPITULLI II Objekti i Shoqërisë

Neni 5. Objekti i Shoqërisë

5.1. Objekti i aktiviteteve të Shoqërisë është si më poshtë:

Objekti i aktiviteteve të Shoqërisë është tregtim i paisjeve elektronike dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe mediavizive. Tregti, eksport-import, furnizime, instalime dhe mirëmbajtje e pajisjeve elektronike, informatike, audiovizive, të aparturave teknike. Instalime, zhvillim, implementim dhe mirëmbajtje të rrjeteve të komunikimeve elektronike.

5.2. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i sipërpermendur, Shoqëria mund:

- i. të kryejë cdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe cdo aktivitet tregtar, financiar, dhënie-marrje me qera, të vendosë pengje dhe barrë hipotekore; aktivitetet këto të konsideruara si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të cituara më sipër;
- ii. të blejë në menyrë direkte apo indirekte, kuota të shoqërive të tjera që kanë një objekt të përafërt me atë të Shoqërisë, në Shqipëri ose jashtë shtetit;
- iii. të kryejë cdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm ose i domosdoshëm për të arritur qëllimin e aktivitetit të saj.

5.3. Shoqëria duhet të kryejë cdo aktivitet që përfshihet në objektin e saj, në lidhje dhe që e favorizon atë.

5.4. Shoqëria duhet të respektojë të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse. Ajo përfshin standartet më të mira etike.

Neni 6. Ndryshimet

6.1. Shoqëria rezervon të drejtën për të ndryshuar objektin në cdo kohë, ashtu sic përcaktohet në statut.

KAPITULLI III
Kapitali themeltar dhe Ortakët e Shoqërisë

Neni 7. Kapitali themeltar dhe Ortakët e Shoqërisë

- 7.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën 100.00 (nje qind)Lekë dhe është i ndarë në 1 kuotë.

Ortaku i Vetem i Shoqërisë dhe kuota përkatëse e tij është si më poshtë:

- **Z. Erald Taga**, shtetas shqiptar, lindur më 03/08/1987, në Kruje, banues në adresën: Lagja Kovace nr 3 ,mbajtës i pasaportës BE0006393 dhe nr. personal I70803008D, zotërues i 1 (një) kuote të barabartë me 100.00 (nje qind)Lekë, dhe që përfaqëson 100 (njeqind për qind) ë kapitalit të shoqërisë”:

- 7.2 Vlera e kuotës së ortakeve dhe përqindja e pjesëmarrjes që ortaket zotërojnë në kapitalin themeltar regjistrohet në librin e ortakëve të Shoqërisë.
- 7.3 Përgjegjësia e ortakeve për mbulimin personalisht të humbjeve të Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e pashlyer të kontributit të tij në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 8. Zvogëlimi dhe Zmadhimi i Kapitalit Themeltar

- 8.1 Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet me vendim të asamblesë, në çdo kohë dhe më shumë se një herë, përmes kontributeve në para’ apo në natyrë, në zbatim të ligjeve në fuqi, në momentin e zmadhimit ose zvogëlimit të kapitalit dhe të këtij statuti. Vendimet e asamblesë lidhur me zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë duhet të merren me shumicën e nevojshme të parashikuar për ndryshimin e këtij statuti.
- 8.2 Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet me vendim të asamblesë, në zbatim të ligjeve në fuqi dhe të statutit. Në çdo rast, kapitali i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet përtej minimumit të parashikuar me ligj.
- 8.3 Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë perballohet nga secili prej ortakëve në përpjesëtim me kuotat që ka në kapitalin e Shoqërisë.

Neni 9. Transferimi i Kuotave

- 9.1. Kuotat janë lirisht të transferueshme tek cdo individ ose person juridik nëpërmjet kontratës së shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose nëpërmjet cdo mënyre tjetër të parashikuar në ligj.

KAPITULLI IV
Asambleja e Përgjithshme

Neni 10. Kompetencat

- 10.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi vendimmarrës i Shoqërisë i cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.
- 10.2 Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vlefshmërisht vendime nëse janë të pranishëm ortakët te cilet përfaqësojnë më shumë se 30% të votave. Në rastin kur ky kuorum nuk arrihet në thirrjen e parë, Asambleja e ortakëve do të thirret sërish me të njëjtin rend dite brenda dhe jo përtej 30 (tridhjetë) ditëve duke filluar nga thirrja e parë; kuorumi mbetet i njëjtë.
- 10.3 Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë një shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vlefshmërisht vendime, vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se 50% të votave janë të pranishëm. Në rastin kur ky kuorum nuk arrihet në thirrjen e parë, Asambleja e ortakëve do të thirret sërish me të njëjtin rend dite brenda dhe jo përtej 30 (tridhjetë) ditëve duke filluar nga thirrja e parë; kuorumi mbetet i njëjtë.
- 10.4 Merren vlefshmërisht me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, vendimet që kanë si objekt çështjet në vijim:

- i. përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
 - ii. emërimin dhe shkarkimin e administratorit/ëve dhe vendos për shpërblimin e tij/tyre;
 - iii. emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar dhe vendos për shpërblimin e tyre;
 - iv. mbikqyrjen e zbatimit dhe të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - v. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë;
 - vi. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - vii. përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera kundër administratorit/ëve;
 - viii. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - ix. çështje tjetër të caktuar nga ligji dhe ky statut.
- 10.5. Merren vlefshmërisht me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë **75% të ortakëve pjesëmarrës**, sipas kuorumit të përcaktuar në paragrafin 10.3, vendimet që kanë si objekt çështjet në vijim:
- (i) ndryshimet e statutit;
 - (ii) rritja dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë;
 - (iii) transformimi i Shoqërisë;
 - (iv) miratimi i projekteve të bashkimit dhe ndarjes;
 - (v) shpërndarja e fitimeve;

Neni 11. Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme e thirrur rregullisht përfaqëson të gjithë ortakët dhe vendimet e saj, të marra konform ligjit dhe këtij statuti, përbejnë detyrim ligjor për të gjithë ortakët, edhe nëse mungojnë ose nuk janë të të njëjtit mendim.
- 11.2 Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët, edhe jashtë selisë së Shoqërisë, por brendaterritoritë Shqipërisë, me letër rekomande' dërguar ortakëve në vendbanimin që rezulton nga libri i ortakëve, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë.
- 11.3 Asambleja mund të thirret gjithashtu edhe nga eksperti kontabël i autorizuar, nëse ka të tillë, ose nga një apo disa ortakë që përfaqësojnë të paktën 5 (pesë) për qind të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë.
- 11.4 Në njoftimin e thirrjes duhet të tregohen vendi, dita dhe ora e mbledhjes dhe lista/ rendi e/i çështjeve që do të trajtohen. Në mungesë të formaliteteve si më sipër asambleja konsiderohet

- e mbledhur rregullisht nëse në të perfaqësohet i gjithë kapitali themeltar dhe askush nuk kundërshton trajtimin e çështjeve të rendit të ditës. Asambleja drejtohet nga administratori.
- 11.5 Asambleja emëron një sekretar, edhe jo ortak dhe, nëse nevojitet, një ose disa vëzhgues, edhe jo ortakë.
 - 11.6 Kryetari i asamblesë konstaton mbledhjen e rregullt të saj, verifikon identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmeve, drejton dhe garanton zhvillimin e rregullt të mbledhjes së asamblesë si dhe verifikon dhe shpall rezultatet e votimeve.
 - 11.7 Mbledhjet e asamblesë mund të mbahen edhe me video-konferencë ose në tele-konferencë, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe të dallohen në çdo moment të lidhjes, dhe t'u lejohet të ndjekin diskutimin, të marrin, transmetojnë dhe/ose vëzhgojnë dokumentet, të ndërhyjnë gojarisht dhe në kohë reale mbi të gjitha çështjet, si dhe të marrin pjesë në votim dhe të bejne të mundur që vendimi të merret, në mënyrë të tillë që të mund të garantohet vendimmarrja kolegjiale, zbatimi i parimeve të mirëbesimit dhe barazisë së trajtimit të ortakëve.
 - 11.8 Në prani të kushteve të mësipërme, asambleja e përgjithshme konsiderohet e mbajtur rregullisht në vendin në të cilin gjendet drejtuesi i saj dhe ku duhet të ndodhet gjithashtu edhe sekretari, ku të mundësohet hartimi dhe nënshkrimi i procesverbalit në librin përkatës.
 - 11.9 Çdo ortak ka të drejtën e pjesëmarrjes dhe të votës në asamble në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës që zotëron në kapitalin e Shoqërisë.
 - 11.10 Ortakët mund të përfaqësohen në asamble nga persona të tjerë, edhe jo ortak, nëpërmjet një prokure të posaçme të lëshuar konform dispozitave ligjore në fuqi; rregullshmëria e prokurës do të verifikohet nga Kryetari i asamblesë.
 - 11.11 Prokura është e vlefshme vetëm për asamblenë përkatëse për të cilën lëshohet, e cila identifikohet në bazë të rendit të ditës. Ortaku nuk mund të japë prokurë për të votuar për një pjesë të kuotave së tij në kapitalin e Shoqërisë, nëse voton personalisht për pjesën e mbetur.
 - 11.12 Vota duhet të jetë e hapur ose gjithësesi e shprehur me modalitete të tilla që bëjnë të mundur identifikimin e ortakëve që nuk janë të të njëjtit mendim. Modalitetet e votimit miratohen nga asambleja, me propozim të Kryetarit, me shumicën e të pranishmëve.
 - 11.13 Vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes, të nënshkruar nga Kryetari dhe sekretari ose nga noteri, në rastet e parashikuara me ligj.
 - 11.14 Vendimet e ortakëve do të mund të merren edhe nëpërmjet vendimit qarkullues me shkrim siç vijon.

Vendimet e propozuara, me iniciativën e një apo më shumë administratorëve apo të së paku një prej ortakëve, do t'i dërgohen të gjithë ortakëve, me cilindo mjet të shkruar, faks, telefax, poste elektronike apo postë të regjistruar.

Prej propozimit duhet të rezultojë qartë çështja objekt i vendimit qarkullues, arsyet dhe çka është e nevojshme për të siguruar një informacion të përshtatshëm mbi çështjen për t'u trajtuar, sikurse edhe teksti i saktë i vendimit për t'u marrë.

Secilit ortak do t'i kërkohet t'a dërgojë votën e tij me fax, poste elektronike apo telefax të konfirmuar me postë të regjistruar në dokumentin e dërguar, brenda afatit të treguar në propozim; mungesa e përgjigjes prej ortakëve brenda afatit të sipërpërmendur do të konsiderohet si votë kundër.

Vendimi do të konsiderohet i marrë kur (a) të gjithë ortakët kanë aprovuar paraprakisht diskutimin e çështjes objekt të vendimi qarkullues me shkrim dhe (b) miratimet me shkrim te ortakëve të arrijnë kuorumin e kërkuar prej statutit.

Vendimi duhet të jetë i qartë dhe i pakushtëzuar dhe nga ai duhet të rezultojë nëse votimi ka qenë pro apo kundër vendimit të diskutuar.

Administratorët do të mbledhin vendimet e miratuara apo te refuzuara dhe do të njoftojnë ortakët mbi rezultatet e vendimit qarkullues me shkrim duke treguar ortakët që janë shprehur pro, ata që janë shprehur kundër dhe ata që kanë abstenuar, dhe vlerën e kapitalit të përfaqësuar nga secili prej tyre si dhe datën në të cilën është miratuar vendimi. Konsiderohet si datë e miratimit të vendimit data në të cilën mbaron afati i treguar në propozim.

Administratorët dhe/ose ortakët kanë të drejtë të kontrollojnë të gjithë dokumentet lidhur me çdo vendim qarkullues me shkrim.

KAPITULLI V **Administratori**

Neni 12. Administratori dhe kompetencat

- 12.1. Shoqëria drejtohet nga Administratori **Z. Erald Taga**, shtetas shqiptar, lindur më **03/08/1987**, në Krujë, banues në adresën: Lagja Kovace nr 3 ,mbajtës i pasaportës **BE0006393** dhe nr. personal **I70803008D**, i cili është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë, dhe përfaqëson Shoqërinë para të tretëve. Administratori mund të jetë i cdo kombësie dhe nuk është e nevojshme të jetë rezident në Shqipëri. Kompetencat e tij përcaktohen në bazë të Ligjit të Shoqërive dhe Statutit të Shoqërisë.

- 12.2. Kohëzgjatja e emërimit të Administratorëve është për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, duke filluar që nga momenti që ky statut nënshkruhet, me të drejtë ripërtëritje të këtij mandati.
- 12.3. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në cdo kohë, me shumicë të zakonshme.
- 12.4. Asambleja e Përgjithshme përcakton numrin e administratorëve të Shoqërisë.

Neni 13. Kompetencat dhe detyrimet

- 13.1. Administratori vepron në lidhje me cdo çështje të Shoqërisë që nuk është caktuar nën autoritetin e Ortakëve në përputhje me këtë Statut, dhe cdo apo të gjithë vendimeve të Ortakëve si dhe ligjeve të zbatueshme.

KAPITULLI VI
Aktiviteti i Shoqërisë

Neni 14. Viti Financiar

- 14.1. Viti financiar fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron më 31 Dhjetor të cdo viti. Viti i parë financiar fillon në ditën e parë që është themeluar Shoqëria.

Neni 15. Mbajtja e Llogarive

- 15.1. Shoqëria mban financat në lekë dhe mban bilancin dhe llogaritë në përputhje me ligjin në Shqipëri.

Neni 16. Fitimet

- 16.1. Fitimet që rezultojnë nga bilanci ushtrimor do të shpërndahen ndërmjet ortakëve, proporcionalisht me kuotat që ata kanë respektivisht në kapitalin e Shoqërisë, pasi të jenë

zbritur nga kjo shumë (i) vlera e humbjeve të pësuar gjatë vitit ushtrimor paraardhës si dhe (ii) të gjitha shumat e tjera që Asambleja e Përgjithshme vendos të destinojë për fondet e rezervës.

Neni 17. Prishja e Shoqërisë

17.1 Shoqëria mund të priset në rrethanat e mëposhtme:

- (i) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilin është themeluar;
- (ii) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- (iii) në rast se objekti bëhet i perealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- (iv) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga Neni 3/1 të Ligjit Tregtar;
- (v) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- (vi) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- (vii) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e përgjithshme.

17.2. Administratori (et) regjistrojnë prishjen e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me nenin 43 të Ligjit nr.9723, date 3.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar (“**Ligji për regjistrimin e biznesit**”). Në rast se prishja e Shoqërisë behet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të Ligjit për regjistrimin e biznesit, ia dërgon vendimin QKB-së për regjistrim.

KAPITULLI VIII **Të ndryshme**

Neni 18. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

18.1. Cdo mosmarrëveshje, kundërshti ose pretendim midis Shoqërisë dhe një ose më shumë Ortakëve, që rrjedh ose në lidhje me këtë statut ose shkeljen, përfundimin ose pavlefshmërinë e tij, duhet t'i referohet dhe përfundimisht të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Neni 19. Tërheqja e Ortakëve

19.1. Tërheqja ose përjashtimi i një Ortaku si dhe pasojat e këtij veprimi do të rregullohen nga Nenet 101, 102 dhe 103 të Ligjit Shqiptar Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar (“**Ligji për Shoqëritë Tregtare**”).

Neni 20. Ligji i zbatueshem

20.1. Ky Statut rregullohet nga dhe duhet të interpretohet sipas ligjeve shqiptare në momentin e nënshkrimit të tij.

20.2. Me ndryshimin e ligjeve të zbatueshme, Asambleja e Përgjithshme do të reflektojë ndryshimet e dispozitave urdhëruese në këtë Statut.

Neni 21. Dispozita e fundit

21.1. Ky Statut është redaktuar në 4 (katër) kopje në Shqip.

ORTAKU I VETEM

Erald Taga

ERALD TAGA

